




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

S.T.I.M. r.v.
- Sek. Bujqësisë
- Dyt. Juridike
07.06.2023

Nr. 3286 / prot.
2



Tiranë, më 06.06.2023

Lënda: Njoftim për shpallje.

BASHKISË MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Me Kontratën e Qirasë me Nr. 826 prot., Nr. 274 Rep., Nr. 53 Kol., datë 21.1.2021, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me cilësinë e Qiradhënësit, i ka dhënë me qira subjektit "Leonard Angoni", Person Fizik, tokën bujqësore në pronësi të shtetit, të përbërë nga pasuritë me Nr. 134; Nr. 136; Nr. 137/21; Nr. 137/22; Nr. 139; Nr. 148; Nr. 469; me sipërfaqe totale 10.1313 ha, Zona Kadastrale Nr. 1667, me vendndodhje në Fushë Maliq, Bashkia Maliq, qarku Korçë, me qëllim ngritjen e plantacionit me arrë, me një afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

Me tonën me Nr. 5685 prot., datë 7.11.2022, lënda "Mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë", është njoftuar subjekti "Leonard Angoni", Person Fizik, mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë si dhe detyrimin e tij për të paguar penalitetet për mosrealizim të investimeve të planifikuara në plan biznes në shumën 731,772.80 (shtatëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë) lekë.

Me shkresën me Nr. 787 prot., datë 2023, lënda "Njoftim për kryerjen e pagesës së vlerës së qirasë vjetore të tokës bujqësore në pronësi të shtetit" subjekti është njoftuar për kryerjen e vlerës së qirasë vjetore, për vitin 2023, në vlerën 105,000 (njëqind e pesë mijë) lekë.

Shkresat si më lart i janë dërguar subjektit "Leonard Angoni", Person Fizik për njoftim me shërbim postar, por janë kthyer pa marrë dijeni subjekti, me shënimin "Larguar".

Nr. 58 Prot

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, Tiranë; Tel/Fax: 04 2226911; Web: www.bujqesia.gov.al

Në pamundësi për të njoftuar subjektin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë, duke pasur parasysh efektivitetin e aktit, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën, bazuar në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pjesa e shtatë “Njoftimi”, Kreu II “Mënyrat dhe mjetet e njoftimit”, Seksioni 1 “Njoftimi me postë dhe mjete elektronike”, neni 162 “Njoftimi publik”, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, në të cilin parashikohet se: “Njoftimi publik bëhet në këto raste: b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur”... pika 2, parashikohet se: “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, kërkojmë shpalljen e njoftimit për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë në ambientet ku ushtrojnë aktivitetin institucionet tuaja.

Referuar Kodit të Procedurave Administrative, neni 162 “Njoftimi publik”, pika 3, në të cilin parashikohet se: “Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara”, publikimi i këtij njoftimi të jetë për një afat 10 ditë nga data e shpalljes.

Bashkëlidhur shkresës gjeni njoftimin në formë shkresore për shpallje.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(I KOMANÐUAR)

MIRGEN DOBRUNA

